



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3377/ 17 prot.

Datë 05.05.2026

V E N D I M
Nr. 589 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 116/2026, datë 22.01.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.

Ankimues: Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, me Nipt M38106801F, Adresa: BARAJ, 01960008 Nd.64, H.1, Mallakastër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Belsh.
Adresa: Belsh Qendër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1.Me Vendimin Nr. 116/2026 datë 22.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.
2. Të deklarojë pavlefshmërinë absolute të kontratës.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit sipas konstatimeve të këtij vendimi.
4. Të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Z. Arif Tafani, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Belsh.
5. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
6. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim
7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Idealdevs Corporation” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1172 prot., datë 20.04.2026, protokolluar me tonën nr. 3377/14 prot., datë 29.04.2026, autoriteti kontraktor *Bashkia Belsh*, informon se ka zbatuar vendimin Nr.116/2026, datë 22.01.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1172 prot., datë 20.04.2026, protokolluar me tonën nr. 3377/14 prot., datë 29.04.2026, autoriteti kontraktor *Bashkia Belsh*, informon se ka zbatuar vendimin Nr.116/2026, datë 22.01.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor informon se:

[...]Në zbatim të vendimit Nr.116/2026, datë 22.01.2026, AK ka marrë masa të menjëhershme me hartimin e:

1. Urdhrit të Titullarit Mbi zbatimin e Vendimit të KPP-së.
2. Formulari i Anulimit të procedurës së prokurimit.
3. Njoftim për Operatorët Ekonomikë, pjesmarrës në këtë procedurë mbi zbatimin e Vendimit të KPP-së.

II.2.Komisioni, referuar shkresës sipërcituar si edhe dokumenteve provuese bashkëlidhur saj, konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.116/2026, datë 22.01.2026 të KPP-së.

Komisioni gjykon të lejojë Autoritetin Kontraktor të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit objekt gjykimi dhe në rast ripublikimi të procedurës AK duhet të mbajë në konsideratë Vendimet e KPP-së në lidhje me këtë procedurë, me qëllimin që procedura të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore Për prokurimin publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm me anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

